



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.10, Datë 08.04.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E  
HIDROCENTRALIT "TRUEN", KOMUNA BLERIM, QARKU SHKODËR

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar, VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 "Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e hidrocentralit "Truen" në përroin Truen, Komuna Blerim, Qarku Shkodër, me kërkues shoqërinë koncesionare "Truen" Sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a) Dokumenti i Rregullores së Lejes Zhvillimore Komplekse,
  - b) Harta e Planvendosjes së Strukturave.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore Komplekse i jepet subjektit kërkues pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

EDI RAMA

**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



**Z. DAMIAN GJIKNURI**

MINISTËR I ENERGJISË DHE INDUSTRIË



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT